

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

### Qëndrimi i drejtë / *el-Istikaameh* / **الِاسْتِقَامَةُ**

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"فَاسْتَقِيمُوا إِلَيْهِ"

"... qëndroni drejt në rrugëtimin për tek Ai"<sup>1</sup> (Fussilet, 6)

Qëndrimi i drejtë është një frymë nëpërmjet së cilës vihen në jetë të gjitha gjendjet (*ahwaal*) dhe lulëzojnë e shtohen veprat e njerëzve të zakonshëm. Qëndrimi i drejtë është një zonë mes gropave të shpërhapjes dhe majave të njësimiit.<sup>2</sup> Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë i qëndrimi drejt në përpjekjet për të qenë mesatar:

- Pa kundërshtuar skemën e dijes<sup>3</sup>
- Pa kapërcyer caqet e devotshmërisë<sup>4</sup>
- Pa devijuar nga Suneti<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Kur Sufjan ibn Abdullah erdhi të peygamberi ﷺ, siç na përcillet nga Muslim, dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, më trego një gjë për Islamin për të cilën s'do të kem nevojë ta pyes dikë tjetër." Ai ﷺ tha: "Thuaj 'Besoj në Allahun' dhe qëndro i drejtë." Fuqia e drejtësisë në të folur si edhe spontaniteti, elokuenca dhe saktësia e përgjigjes së peygamberit ﷺ të bëhet e qartë, kur t'i shohësh sinonimet e kësaj shprehjeje (qëndrimin të drejtë): çiltërsi, ndershmëri, besnikëri, integritet, moral, vërtetësi, mirësi, drejtësi, virtyt, nder, vetëdije.

<sup>2</sup> Ky është rrugëtimi prej ultësirave të shpërhapjes e shpërqëndrimit, kur të parët tënd është i fshehur nga drita e së vërtetës, për tek majat e njësimiit dhe bashkimit ku ti mund ta shohësh të vërtetën.

<sup>3</sup> Harta e tërë udhëtimit përpilohet vetëm në përputhje me dijen e Sheriatit.

<sup>4</sup> Pasi të veprosh sipas udhëzimit të Sheriatit të Tij në kërkim të kënaqësisë së Tij, do të kesh përmbushur kërkesat e pranimit.

Niveli i dytë është qëndrimi i drejtë i gjendjeve. Kjo nënkupton:

- Të mos shohësh të vërtetën si një arritje personale<sup>6</sup>
- Mospranimin e të gjitha pretendimeve, jo vetëm mospranimin e pretendimit për shkak të të qenët tënd në përputhje me dijen<sup>7</sup>
- Qëndrimi në dritën e zgjimit, pa shikuar kujdesin vetjak (për dritën)<sup>8</sup>

Niveli i tretë është qëndrimi i drejtë:

- Duke mos parë të qëndruarit tënd të drejtë<sup>9</sup>
- Duke hequr vëmendjen nga ndjekja e qëndrimit të drejtë nëpërmjet shikimit në ruajtjen dhe në mbajtjen e së vërtetës nga ana e Tij, i lartësuar qoftë emri i Tij!<sup>10</sup>

---

<sup>5</sup> Rruga e të Dërguarit është ose e obligueshme, që është pjesë e kërkesave të pranimit, ose e rekomandueshme, që është e domosdoshme për shquarjen tënde dhe për nxitjen e shpejtësisë e të qëndrueshmërisë në rrugëtimin tënd. Rruga e të Dërguarit 𐎠 balancon dy ekstremet. Po ashtu, ndryshe nga çdo udhëzim tjetër, ndjekja e hapave të të Dërguarit 𐎠 do të të garantojë siguri, sepse, ndërsa ai ecte, nuk shikonte vetëm veten e vet, por edhe të gjithë ata mbrapa vetes. Kështu nuk qëndron puna e asnjë dijetari, imami a shejhu; këta mund të kapërcejnë ndonjë gropë me forcën a me të tjerat virtyte që kanë ndërsa ata mbrapa tyre të bien në të.

<sup>6</sup> Kështu, pasi ta shohësh të vërtetën, që është njësia e Atij që është një dhe kontrolli i plotë i Tij mbi të gjitha gjërat, nuk do t'ia atribuosh vetes arritjen apo ta shohësh atë si një fitim tëndin. Ti duhet të jesh i bindur se e vërteta është një dhuratë për ty dhe ta çosh ndër mend se, Ai që ta dha, mund të ta marrë kur të dojë.

<sup>7</sup> Cilado gjendje e mirë që ti përjeton, mund të të bëjë që ta pretendosh atë. Pretendimet e këtilla duhet mohuar tërësisht jo vetëm pasi të dish se janë të pavërteta, meqë kjo pritet nga të gjithë njerëzit; jo vetëm që të tregosh mirësjelljen e përlësisë, meqë ti do ta pretendoje e më pas do të heqje dorë prej saj nga përlësia; por për shkak se ti duhet të jesh i vetëdijshëm për mungesën e plotë të ti të ndikimit (*haul*) dhe fuqisë (*kuweh*).

<sup>8</sup> Nëse të është dhënë kjo dritë, mos u largo prej saj. Rri aty ku ajo është, sepse ajo nuk është natyrshëm jotja; ajo vjen prej Tij. Ti nuk e ruan vetë, por Ai e mban aktive.

<sup>9</sup> Niveli i tretë, zakonisht, u kushtohet atyre në shkallën e vetasgjësimit (shih kuptimin e kësaj në kapitujt e parë). Këtu, ti s'do të shohësh rrugën, shenjat në rrugë, të qëndruarit tënd të drejtë apo çfarëdo qoftë tjetër, përfshirë dhe të parët tënd të Atij. Gjithçka do të eklipsohet nga Ai.

<sup>10</sup> Kjo është shkalla apo stacioni i të parët të veprimeve të Tij, jo të tuat. Qëndrimi yt i drejtë s'është gjë tjetër veçse ndreqje që Ai ta bën. Vërej sesi ky nivel nuk bie në kundërshtim apo nuk anulon nivelet paraprake mbi të cila është ngritur. Ti ende duhet t'i përmbushësh kërkesat e nivelit të parë, mirëpo, në këtë nivel kulmor, ti s'do ta shohësh veprimin tënd dhe vullneti yt tashmë do të duhej të përputhej me të Tijin

---

sikur të shpërbëhej në të. Ti nuk do të shohësh gjë tjetër (*gajr*) dhe s'do të pranosh gjë tjetër veç asaj çfarë do dhe pëlqen Ai.